



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 59

Prishtinë, më 21.3.2012, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Liburn Aliu, Rasim Demiri, Nijazi Idrizi, Salih Morina, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Daut Haradinaj, Etem Arifi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: Kryeministri i Kosovës Hashim Thaqi, zyrtar nga MMPH, Ministri dhe këshilltari i ministrit, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar (ICO-Piter Feit me bashkëpunëtor, KDI, OSBE, Ambasada Amerikane, Presidenca), Kryetari i Komisionit për Komunitete-Goran Marinković dhe media.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 19.3.2012,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Hoçën,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.3.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 19.3.2012.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Hoçën

Nait Hasani falënderoi Kryeministrin dhe zyrtarët nga ICO z. Feit etj, për interesimin e treguar rreth projektligjit në fjalë, i cili projektligj sipas këtij komisioni ka qenë mjaft e papërgatitur, mirëpo duke pasur parasysh rrethanat e krijuara të natyrës politike, prapë është vendosur të shqyrtohet projekti.

Piter Feit shkurtimisht përsëriti qëndrimet e tij nga takimet e mbajtura deri tani, sidomos nga takimi i dt. 20.3.2012, dhe shtoi se ky Projektligj në asnjë mënyrë nuk shkel Kushtetutën dhe laicitetin e shpallur me këtë Kushtetutë të këtij vendi. Shembull mori Francën i cili shtet është laik por në Kushtetutën e saj ka dispozita përmes cilave ndihmon shkollat dhe institucionet tjera katolike-fetare, ndërsa në anën tjetër askush nuk konteston që është shtet laik. Megjithatë sugjeroi punë të përbashkët dhe me sukses.

Hashim Thaqi-Kryeministër gjithashtu falënderoi dhe inkurajoi Komisionin në vazhdimin e punës së filluar me këtë Projektligj, ngase siç dihet qysh në janar të këtij viti (takimi i Vjenës) institucionet tona vendore janë zotuar për përmbylljen e mbikëqyrjes së pavarësisë së Kosovës, duke falënderuar shtetet mike. Kjo përmbyllje e mbikëqyrjes së pavarësisë, vazhdoi, është mbështetur nga Parlamenti dhe liderët politik, ndërsa në vazhdim mbeten edhe 4-5 çështje të rëndësishme të procedimeve parlamentare, për të arritur te caku i dëshiruar, gjithnjë në harmonizim me ICO dhe miqtë ndërkombëtar. Ai shprehu mendimin që sugjerimet e ICO duhet të përkrahen nga Komisioni, dhe propozoi që nesër apo sot nga ora 17,00 të vazhdoi puna e Komisionit për amendamentet veq e veq.

Liburn Aliu konstatoi se kemi të bëjmë me një urgjencë që kërkohet nga Komisioni sa i përket këtyre dy ligjeve të rëndësishme, ndaj pyeti : “pasi që janë këto dy projekte aq të rëndësishme, ndërsa dihet se ngutia shkakton gabime, pse kërkohet prapë të bëhen gabime, sikurse me Ligjin për ZVM”, dhe propozoi që megjithatë mos të ngutet Komisioni, ngase bëhen ligje diskriminuese.

Hashim Thaqi tha se me dëshirën personale dhe pa ndërhyrje partiake ka ardhur në këtë takim për të kontribuar aq sa është mundësia, ndërsa Komisioni pasi që u pajtua për shqyrtim detal të amendamenteve, u vendos që nesër më 22.3.2012 bashkërisht të mbahet mbledhja e komisionit.

Komisioni, pasi që përfundoi mbledhja, vazhdoi në takimin me MMPH në GËRMIA ku u shqyrtua me ekspertët nga USAID Projektligji për Ndërtimin, para se të dal në leximin e parë në Kuvend. Në këtë takim anëtarët e komisionit dhanë vërejtje dhe sugjerime për të plotësuar këtë projekt, të cilat u mirëpritën nga propozuesi i ligjit dhe të cilat do të realizohen pas leximit të parë në Kuvend.

Mbledhja përfundoi në orën 11,15 ndërsa takimi në GËRMI përfundoi në orën 15,15.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani